



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:116813

Datë: 08.07.2024

Numri i dokumentit: 05907859

PKR.nr.314/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë, përkatësisht gjyqtari **Naser Foniqi** – kryetar i trupit gjykues -KTGJ dhe gjyqtarët **Fatime Dërmaku e Ertan Sejfulla**, anëtarë të trupit gjykues - ATGJ, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita Hoxha Koleci, në çështjen penale të akuzuarve: **V.T.**, i akuzuar për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale: posedimi i paautorizuar narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par. 1 të Kodit nr. 06/L - 074 Penal të Republikës së Kosovës - në vijim KPRK; Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK dhe Falsifikimi i parasë nga neni 296 par. 2 të KPRK; dhe **F.Q. e D.Sh.**, të akuzuar për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par. 2, lidhur me nenin 31 të KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda **PP.I.nr.132/2023, të datës 13.10.2023**, pas shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datat **01.03.2024, 24.05.2024 dhe 14.06.2024**, në të cilin ish-in të pranishëm prokurori i shtetit **Dulina Hamiti** dhe të akuzuarit: **V.T.** me mbrojtësen e tij av. Sahadete Gashi me autorizim; **F.Q.** me mbrojtësin e tij av. Naim Rudari me autorizim dhe av. Shpend Lushaku me autorizim zëvendësues; dhe **D.Sh.** me mbrojtësin e tij av. Gëzim Berisha i caktuar sipas detyrës zyrtare, si dhe **F.S.**, ekspert i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë – në vijim AKF, **me datë 14.06.2024**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I.

I akuzuari V.T., i biri i K. dhe H., e vajzërisë S., i lindur me datë ..., në fshatin ..., Komuna Podujevë, tani me banim në ... lagjia ..., rr. "...” nr. ..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar – baba i një fëmije, i punësuar, realizon pagë mujore prej 500 euro, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenw nën masën e paraburgimit nga **datw 22.05.2023 deri me datw 18.10.2023**;

ËSHTË FAJTOR

I/1. S e p s e: me datë 22.05.2023 rreth orës 14:20, i pandehuri V.T. pa autorizim ka poseduar substanca narkotike prej 3.92 gram e llojit marihuanë, e cila është gjetur dhe sekuestruar nga Policia e Kosovës në shtëpinë e tij në rrugën "...” nr. ... në Prishtinë,-
- me këto veprime, ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK, dhe

I/2. S e p s e: i pandehuri V.T. ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla, përkatësisht me datë 22.05.2023 rreth orës 14:20 në shtëpinë e tij në rr. "...", nr. ..., në Prishtinë gjatë bastisjes nga ana e policisë kanë gjetur dhe sekuestruar një karikator me 16 fishekë të kalibrit 9x19mm,-

- me këto veprime, ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 38; 42; 43; 69; 70; 71; 72, par. 1, nënpar. 1.5; 79; 269 par. 1 dhe 366 par. 1 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale – në vijim KPP, të akuzuarit **V.T.** i shqipton:

DËNIM ME GJOBË DHE BURGIM

- **Dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) euro dhe**
- **Dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj,** për veprën penale posedimi i paautorizuar narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK, si dhe
- **Dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500) euro,** për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK, **e të cilat dënime do të ekzekutohen pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.**
- Dënimet me gjobë si më lart, i akuzuari mund t'i paguaj deri në tre këste.
- Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata do t'i caktoj të dënuarit një ditë burgimi për 20 € të gjobës.
- **Në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarit V.T. i llogaritet koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 22.05.2023 deri me datë 18.10.2023.**
- Detyrohet i akuzuari **V.T.** që të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa dalin sipas regjistrimit të shpenzimeve, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **pesëdhjetë (50) € dhe pesëdhjetë (50) € në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimin,** në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- **Nga i akuzuari V.T., konfiskohen dhe shkatërrohen substancat narkotike prej 3.92 gram e llojit marihuanë dhe një karikator me gjashtëmbëdhjetë fishekë të kalibrit 9x19 mm.**

II.

Konform nenit 363, par. 1 nënpar. 1.3 të KPP, të **akuzuarit:**

V.T., me të dhëna personale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi,

F.Q., i biri i N. dhe H.e, e vajzërisë H., i lindur me datë ... në Prishtinë, me banim në Pejë, ..., kati ..., numër ..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar – baba i dy fëmijëve, i punësuar – realizon të hyra mujore rreth 700-800 euro, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, **ka qenë nën masën e paraburgimit nga data 30.05.2023 deri me datë 18.10.2023, dhe**

D.Sh., i biri i M. dhe F., e vajzërisë D., i lindur me datë ..., në Pejë, rruga "...", numër ..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar – baba i një fëmije, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës,

LIROHEN NGA AKUZA

S e p s e: me datë 21.05.2023 rreth orës 16:45, në tarracën e restorantit “Univers” në Pejë, të pandehurit F.Q. e D.Sh., në bashkëkryerje me të pandehurin R.N., i cili gjendet në arrati, i kanë vënë në qarkullim paratë e falsifikuara, përkatësisht 94 kartëmonedha nga 50 euro, gjithsej 4700 (katër mijë e shtatëqind) euro të falsifikuara, duke ia dhënë të njëjtat të pandehurit V.T. për t'i vënë në qarkullim, ndërsa me datë 22.05.2023 rreth orës 14:20, i pandehuri V. duke e ditur se paraja është e falsifikuar ka vënë në qarkullim, e ka transportuar, pranuar, poseduar ose e ka përdorur me qëllim që ta vë në qarkullim si të vërtetë, në atë mënyrë që, në shtëpinë e tij në Prishtinë, në rrugën "...", numër ..., gjatë kontrollit, policia ka gjetur dhe sekuestruar paratë si më lart, të cilat sipas Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, kanë rezultuar të jenë pjesërisht të falsifikuara,-

- Pasi që, nuk është provuar se kanë kryer veprën penale Falsifikimi i parasë në bashkëkryerje nga neni 296 par. 2, lidhur me nenin 31 të KPRK.
- **Nga të akuzuarit V.T., F.Q. e D.Sh., konfiskohen dhe shkatërrohen paratë e sekuestruara, përkatësisht 94 kartëmonedha nga 50 euro, gjithsej 4700 (katër mijë e shtatëqind euro) si pjesërisht të falsifikuara.**
- Të gjitha shpenzimet e procedurës penale për pikën II të këtij aktgjykimi bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

ARSYETIMI

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën **PP.I.nr.132/2023, të datës 13.10.2023**, ka akuzuar të pandehurit: **V.T.**, i akuzuar për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale: Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK; Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK dhe Falsifikimi i parasë nga neni 296 par. 2 të KPRK; dhe **F.Q. e D.Sh.**, të akuzuar për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par. 2, lidhur me nenin 31 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 18.10.2023, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari V.T. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, pastaj për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK **e ka pranuar fajësinë**, ndërsa për veprat penale Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 KPRK dhe Falsifikimi i parasë nga neni 296 par. 2 të KPRK **është deklaruar i pa fajshëm, derisa të akuzuarit F.Q. e D.Sh. janë deklaruar të pafajshëm për veprat penale për të cilat janë akuzuar.**

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.03.2024, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari V.T. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar I pa fajshëm për veprat penale Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 KPRK dhe Falsifikimi i parasë nga neni

296 par. 2 të KPRK, e po ashtu edhe të akuzuarit F.Q. e D.Sh. janë deklaruar të pafajshëm për veprën penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par. 2, lidhur me nenin 31 të KPRK.

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari V.T. për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK, prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari V.T., pasi ky pranim është bërë vullnetarisht dhe është bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe me gjendjen faktike të përshkruar në pikën tre të aktakuzës.

Edhe mbrojtësja e të akuzuarit V.T., av. Sahadete Gashi, është pajtuar me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj, pasi që i njëjti është konsultuar mjaftueshëm me të si mbrojtëse.

Pastaj, gjykata ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari V.T., për veprën penale si në pikën III të dispozitivit të aktakuzës, pasi që KTGJ është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit se ky pranim është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, dhe se ky pranim nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimit apo premtimit, si dhe është mbështetur në faktet që përmban aktakuza e cila nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Në fjalën hyrëse prokurori i shteti ka deklaruar se aktakuza e ngritur nga prokuroria është mbështetur në prova dhe dëshmi të mjaftueshme të cilat do të administrohen gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç janë: raporti i ekspertimit AKF/2023-1829/23-1693 i datës 18.07.2023, lidhur me ekzaminimin e substancës narkotike; raporti i ekspertimit AKF/2023-1828/23-1692 i datës 23.06.2023 lidhur me ekzaminimin e parave; vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 22.05.2023 nr.R-2023-XI-DKKO-HTN-NJHMH-3; procesverbali i kontrollit i datës 22.05.2023; raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, i datës 22.05.2023 nga njësia e forenzikës; lista e dëshmimeve nga njësia e forenzikës, i datës 22.05.2023; foto albumi nga njësia e forenzikës, i datës 22.05.2023; vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 30.05.2023 me nr. 2023-KE-147; procesverbali mbi kontrollin, i datës 30.05.2023, me administrimin e të cilave do të vërtetohej gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë dhe do të vërtetohej se të akuzuarit si më lart janë fajtorë për veprat penale për të cilat akuzohen. **Ndërsa në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit** në fillim ka bërë precizimin e dispozitivit të parë të aktakuzës sa i përket sasisë së narkotikut ku ishte shënuar “487 gram të llojit marihuanë” duhet të jetë “3.92 gram e llojit marihuanë”, ashtu siç ishte paraqitur në raportin e AKF të datës 18.07.2023, andaj ka hequr pjesën e fundit në dispozitivin e parë ku shkruan “me peshë 5 gram dhe 1 gram”. Pastaj, prokurori i shtetit ka thënë se me administrimin e provave dhe dëshmimeve gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të plotë është vërtetuar se i akuzuari V.T. ka kryer veprat penale si në hyrje të këtij procesverbali, si dhe është vërtetuar në mënyrë të plotë se edhe të akuzuarit F.Q. e D.Sh. në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar. Po ashtu, prokurori i shtetit ka deklaruar, se të pandehurit si më lart kanë kryer veprat penale si në aktakuzë është vërtetuar nga administrimi i provave materiale, duke shtuar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit si më lart t’i shpallë fajtorë dhe t’i dënoj sipas ligjit.

Në fjalën hyrëse të përgatitur me shkrim, mbrojtësja e të akuzuarit V.T., av. Sahadete Gashi, ka deklaruar se në aktakuzë nuk ka asnjë provë që ka të bëjë me të provuarit e ndonjë elementi të veprave penale për të cilat i mbrojturi i saj është akuzuar, pasi që me provat e paraqitura në aktakuzë prokuroria nuk e ka bërë të besueshëm faktin se i mbrojturi i saj ka kryer veprat penale, përkatësisht prokuroria pretendon se i mbrojturi i saj pa autorizim ka poseduar me

qëllim të shitjes substanca narkotike, e për këtë se pari duhet vërtetuar dashja, duke shtuar se i mbrojturi i saj që nga fillimi e ka pranuar faktin se narkotikun e ka pasur për përdorim personal, ndërsa sa i përket veprës penale të falsifikimit të parasë, mbrojtësja Gashi ka thënë se nuk është vërtetuar dashja se i mbrojturi i saj e ka ditur që paraja është e falsifikuar, për ta vënë në qarkullim të njëjtën, përkatësisht sipas raportit të AKF-së ka dalë që kartëmonedhat të jenë pjesërisht të falsifikuara duke theksuar se në rastin konkret prokurori i shtetit në dispozitiv ka përshkruar një gjendje tjetër faktike, përkundër detyrimit ligjor që në bazë të kësaj gjendje të bëjë edhe kualifikimin juridik të veprave penale, duke tejkualuar autorizimet dhe kompetencat e parapara me kod përkatësisht nuk ka përmbushur detyrimet e parapara me nenin 7 të KPP, duke theksuar se, pas administrimit të provave do të vërtetohet se i njëjti nuk e ka kryer këtë vepër penale. **Ndërsa në fjalën përfundimtare të përgatitur më shkrim, mbrojtësja e të akuzuarit V.T., av. Sahadete Gashi ka deklaruar se** duke iu referuar dispozitivit të aktakuzës e cila kishte të bënte me veprat penale të theksuara në pikën 1 dhe 2 të aktakuzës nën supozimin se do të provohej me prova konkrete kryerja e veprës penale, duke shtuar se prokuroria nuk ka arritur ta argumentoj as gjatë shqyrtimit gjyqësor se janë kryer veprat penale që i vihen në barrë të mbrojturit të saj. Pastaj, mbrojtësja Gashi ka përmendur edhe parimin e përgjegjësisë penale nullum crimen nullum poena sine lege, që nënkupton përgjegjësinë individuale dhe personi mund të shpallet fajtor vetëm pasi gjykata të konstatoj se ai ka qenë i përgjegjshëm dhe i fajshëm, pastaj ka shtuar se përshkrimi dhe cilësimi i veprave penale nga prokuroria është i mangët dhe se faktet dhe dëshmitë e prezantuara nga prokuroria nuk kanë paraqitur në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe nuk kanë vërtetuar se V.T. ka ndërmarrë ndonjë veprim inkriminues. Pastaj, mbrojtësja Gashi ka theksuar se sa i përket cilësimit juridik të veprës penale nga neni 267 par.1 i KPRK mbrojtja e ka të paqartë se kujt i ka shitur narkotik i mbrojturi i saj sepse nga provat e propozuara nga prokuroria vërtetohet vetëm elementi i posedimit të narkotikut të cilën i mbrojturi i saj edhe e kishte pranuar se e kishte për posedim personal sepse ishte përdorues i substancave narkotike, me arsyetim se kishte pasur një operacion të vështirë dhe për t'i përballuar dhimbjet herë pas here ka përdorur narkotik, por shitja nuk ishte vërtetuar me asnjë provë, duke shtuar se për tu kryer vepra penale Falsifikim i parasë nga neni 296 par. 2 ligjvënës ka paraparë që kryesi i kësaj vepre me dashje “duke ditur që paraja është e falsifikuar merr, vë në qarkullim, transporton, pranon përdor apo posedon paranë e falsifikuar për ta vënë në qarkullim si të vërtetë, e për këtë edhe raporti i AFK për ekzaminimin e të hollave ka rezultuar se kartëmonedhat janë pjesërisht të falsifikuara. Andaj, i ka propozuar gjykatës që i mbrojturi i saj të lirohet nga akuza për pikën 1 dhe 2 të aktakuzës, ndërsa për veprën penale si në pikën 3 të aktakuzës për të cilën V.T. është deklaruar fajtor, gjykata ta marr si rrethanë lehtësuese dhe t'i shqiptoj dënim sa më të butë përkatësisht dënim me gjobë.

I akuzuari V.T. në fjalën hyrëse ka deklaruar se e mbështet fjalën hyrëse të mbrojtëses së tij dhe nuk ka se çfarë të shtoj. **Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar** se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtëses se tij dhe nuk ka asgjë tjetër për të shtuar.

Në fjalën hyrëse mbrojtësi i të akuzuarit F.Q., av. Naim Rudari ka deklaruar se prokuroria pretendon se F.Q. ka kryer veprën penale Falsifikimi i parasë duke e ditur se janë të falsifikuara 94 kartëmonedha nga 50 euro, të cilat i ka vënë në qarkullim, por para se gjithash, prokuroria nuk ka argumentuar me asnjë provë se ato kartëmonedha që janë gjetur në kontrollimin e një shtëpie kanë derivuar nga F.Q., duke mos mohuar faktin se F.Q. me datë 21.05.2023 i ka kthyer një borxh R.N.-s, i cili një shumë të parave ia ka dhënë V.T., i cili nuk ka marrë asnjë shumë parash nga F.Q., e pavarësisht kësaj, nuk është vërtetuar se paratë e gjetura janë para që V.T. i ka marrë nga R.N., pra, kemi një shkëputje të zingjirit qarkullues të kartëmonedhave që dyshohet se janë të falsifikuara. Pastaj, mbrojtësi Rudari ka thënë se prokuroria pretendon se F.Q. e ka ditur se këto kartëmonedha janë të falsifikuara por në fakt atë nuk kanë mundur ta konstatojnë

as ekspertët e AKF-së dhe specialisti i lartë për dokumente dhe dorëshkrime F.S., të cilët kanë gjetur dhe konstatuar se ato kartëmonedha i posedojnë të gjitha tiparet mbrojtëse të sigurisë sipas teknologjisë standarde të prodhimit por se janë të dëmtuara si rezultat i kontaktit me ndonjë reagjent kimik, përkatësisht nuk është vërtetuar se këto kartëmonedha kanë qenë në dorën e F.Q., por edhe sikur të ishin në dorën e tij, si mundet të supozohet dhe mendohet se ai e ka ditur se janë të falsifikuara, kur ato përmbajnë të gjitha tiparet mbrojtëse, duke shtuar se në vijim të shqyrtimit gjyqësor do të vërtetohet se paratë që prokuroria pretendon se janë të falsifikuara nuk janë të falsifikuara por të dëmtuara, e mbi të gjitha do të vërtetohet se nuk kanë qenë në dorën e F.Q., i cili nuk i ka vënë në qarkullim, ndonëse titulli i veprës penale është falsifikim i parasë dhe se mbetet barrë e prokurorisë që me provat konkrete, duke lënë anash supozimet dhe mëdyshjet t'i ofroj gjykatës dyshimin e bazuar mirë, të mbështetur në prova dhe më pas të kërkoj që i akuzuari F.Q. të shpallet fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet. **Ndërsa në fjalën përfundimtare, mbrojtësi Rudari ka deklaruar** se prokuroria sikurse në fazën e hetimit po ashtu as në këtë proces gjyqësor në gjykatë, nuk ka arritur që t'i ofroj gjykatës prova konkrete me të cilat do t'ia mundësonte gjykatës që të nxirrte një aktgjykim fajësues sa i përket F.Q. lidhur me veprën penale që ia kanë vënë në barrë, duke e akuzuar të njëjtin se kinse me datë 21.05.2023 në bashkëkryerje me R.N. dhe D.Sh. “duke e ditur se paraja është e falsifikuar e kanë vënë në qarkullim”, duke shtuar se “dijeni” siç pretendon prokuroria është rrethanë abstrakte e që ligjvënësi e ka paraparë se dashja, dijenia dhe qëllimi nxirret nga rrethanat faktike, e që shtrohet pyetja se po që se paratë prej 2500 euro që F.Q. ia ka dhënë R.N. me datë 21.05.2023 janë gjetur në shtëpinë e V.T.t si munda ta dijë F.Q. se ato janë të falsifikuara kur ato kanë poseduar të gjitha tiparet standarde të sigurisë e që edhe pas ekzaminimit laboratorik edhe ekspertët nuk kanë mundur të konstatojnë se ato para janë të falsifikuara, pra ekspertet gjatë ekzaminimit kanë konstatuar se paratë e gjetura në shtëpinë e V.T. kanë poseduar të gjitha tiparet e sigurisë përveç se kanë qenë të dëmtuara dhe u është vendosur një hologram i imituar, por nga kjo ekspertët nuk kanë arritur të konstatojnë se ato para janë të falsifikuara dhe se edhe nëse përjashtojmë të gjitha rrethanat e tjera prokuroria në këtë rast ka lënë paqartësi të mëdha në vërtetimin e kësaj çështje. Pastaj, mbrojtësi Rudari ka theksuar se F.Q. me datë 21.05.2023 ia ka kthyer një borxh prej 2500 euro R.N. që më pas prokuroria pretendon se ato para nga R.R. janë bartur te V.T. e më pas të njëjtat janë gjetur në shtëpinë e V.T.t dhe se prokuroria përveç supozimit nuk ka arritur të dëshmoj dhe t'ia vërtetoj gjykatës që në shumën prej 4700 eurosh që janë gjetur në shtëpinë e V.T.t kanë qenë edhe 2500 euro që F.Q. ia ka dhënë R.N., e sido që të jetë meqenëse gjykata e ka shpallë si provë të pa pranueshme procesverbalin e kontrollit të shtëpisë së V.T., ligjërisht e faktikisht gjithçka që është gjetur në shtëpinë e V.T. po që se rezultoni se është gjetur diçka e kundërligjshme ajo nuk ka asnjë alternative tjetër përveç se të shpallet provë e pa pranueshme, pra në veprimet e kundërligjshme siç ka qenë kontrollimi i shtëpisë së V.T. edhe provat janë të kundërligjshme, e për këtë e bindë gjykatën se në asnjë formë nuk mund të shfrytëzohen frytet e një peme te helmuar, duke shtuar se në këtë proces gjyqësor prokuroria ka ofruar dilema dhe mëdyshje por në qoftë se prokuroria ka krijuar së paku mëdyshje te gjykata, ato interpretohen në favor dhe interes të të pandehurit dhe të drejtave të tij dhe ka kërkuar nga gjykata që të marr një aktgjykim të drejtë e të ligjshëm, të qëndrueshëm juridikisht në mbështetje të nenit 363 par. 1 nënpar.1.3 të KPPK, përkatësisht të nxjerr aktgjykim lirues për F.Q., pasi që nuk është vërtetuar se ai ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

I akuzuari F.Q. në fjalën hyrëse ka deklaruar se e mbështet fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij dhe nuk ka se çfarë të shtoj. **Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se** e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka diçka tjetër çfarë të shtoj.

Në fjalën hyrëse mbrojtësi i të akuzuarit D.Sh., av. Gëzim Berisha ka deklaruar se veprimet e të mbrojturit të tij nuk i përshtaten veprimeve të përshkruara në dispozitiv të

aktakuzës, pasi nga provat e mbledhura gjatë fazës së hetimeve në asnjë formë nuk është përmbushur figura e veprës penale Falsifikim i parasë nga neni 296 par. 1 të KPK, duke shtuar se veprimet e përshkruara ndaj të mbrojturit të tij nuk kanë karakter inkriminues në kuptimin penalo juridik, mbi bazën e së cilave gjatë dëgjimit të të pandehurit, provave të siguruara nga organi i akuzës në procedurë paraprake, si dhe raporti nga AKF, do të vërtetohet në tërësi se i mbrojturi i tij nuk e ka kryer veprën penal që i vihet në barrë, e kjo vepër penale as që ka ndodhur. **Ndërsa në fjalën përfundimtare, mbrojtësi Berisha ka deklaruar se** gjatë shqyrtimit gjyqësor, me provat të cilat janë administruar nuk është vërtetuar se i pandehuri D.Sh. ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, duke shtuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se 94 kartëmonedha që janë gjetur gjatë kontrollit të një shtëpie, nuk kanë rrjedhur nga i mbrojturi i tij, andaj nuk është vërtetuar se me cilin veprim konkret i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës, pasi që në bazë të ekspertizës së AKF është konstatuar se kartëmonedhat i kanë të gjitha tiparet mbrojtëse, andaj i ka propozuar gjykatës që në mungesë të provave të mbrojturin e tij ta liroj nga akuza.

I akuzuari D.Sh. në fjalën hyrëse ka deklaruar se e mbështet fjalën hyrëse të mbrojtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtoj. **Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se** pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtoj.

Pas fjalës përfundimtare, të gjitha palët në procedurë kanë deklaruar se nuk kanë ndonjë deklaratë shtesë para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe nuk kërkojnë mbajtjen e një seance tjetër me qëllim të çështjeve të rëndësishme për caktimin e dënimit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë administruar provat materiale të propozuara nga prokuroria në aktakuzë dhe sipas detyrës zyrtare trupi gjykues ka vendosur ta dëgjoj ekspertin e AKF F.S., e të paraqitura si në vijim:

- Raporti i Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr. referencës AKF/2023-1829/23-1693, i datës 18.07.2023- lidhur me ekzaminimin e substancës narkotike;
- Raporti i Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr. referencës AKF/2023-1828/23-1692, i datës 23.06.2023 lidhur me ekzaminimin e parave;
- Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 22.05.2023, me nr. të rastit R-2023-XI-DKKO-HTN-NJHMH-3;
- Raporti i këqyrjes se vendit të ngjarjes i datës 22.05.2023 nga Njësia e Forenzikës;
- Lista e dëshmive nga Njësia e Forenzikës e datës 22.05.2023;
- Foto albumi nga Njësia e Forenzikës i datës 22.05.2023;
- Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 30.05.2023 me nr. rastit 2023-Ke-147; dhe
- Procesverbali mbi kontrollin i datës 30.05.2023.

Pasi të tre të akuzuarit, në bazë të nenit 344 të KPP, veç e veç janë njoftuar se kanë të drejtë të mos deklarohen, e nëse zgjedhin të deklarohen marrja e tyre në pyetje do të zbatohet

në pajtim me paragrafët 2 dhe 4 të këtij neni, të njëjtit ka deklaruar se duan të shfrytëzojnë të drejtën për të mos u përgjigjur- deklaruar.

Dëshmia e ekspertit të AKF F.S., i cili nën betim, në pyetje nga KTGJ, është përgjigjur se e ka përpiluar raportin AKF/2023-1828/23-1692 të datës 23.06.2023 dhe rezultati i ekspertimit të kartëmonedhave ka dalë që ato janë falsifikim i pjesshëm, duke shtuar se gjatë përvojës së tij ka pasur shumë ekzaminime kur kartëmonedhat kanë dalë të jenë falsifikim i pjesshëm, i cili nënkupton modifikim të pa autorizuar të disa pjesëve të dokumentit në këtë rast të kartëmonedhës, duke shtuar se kanë raste kur ka ndërhyrje me fshirje mekanike, kimike, shtim të numrave, fshirje etj., e sa i përket rastit konkret kartëmonedhat i kanë poseduar tiparet e sigurisë sipas standardit por të njëjtat kanë pasur kontakt me ndonjë reagjent kimik dhe gjatë kontaktit iu janë dëmtuar disa tipare të sigurisë, përkatësisht ato nën rrezet Ultra Violete - UV, siç janë fijet sintetike, reaksioni i ngjyrës nën rrezet UV, peri i sigurisë, si dhe kanë pasur ndërhyje apo ndërrim në hologram, i cili është tipar i sigurisë përkatësisht kanë vendosur hologramin e falsifikuar, e në raport janë paraqitur ilustrimet. Pastaj, eksperti S. ka thënë se disa tipare të sigurisë në kartëmonedha vendosen gjatë prodhimit të letrës së kartëmonedhave siç janë shenja yjore, ndërsa hologrami është tipar i cili vendoset pas prodhimit të letrës, përkatësisht vendoset dhe zhvendoset, e kjo mund të bëhet lehtë sepse ai është një shirit holografik dhe vendoset pas prodhimit të letrës së kartëmonedhës, duke theksuar se kartëmonedhat e ekzaminuara kanë qenë në gjendje të rregullt, teknika e printimit është sipas standardit, numrin serik është me shtypje të lartë ashtu siç duhet të jetë, kurse reaksioni i ngjyrës nën rrezet UV është i dëmtuar për shkak të kontaktit dhe se pas ekzaminimeve të kryera, ai ka konstatuar se ndërhyje ka vetëm te hologrami, e deri te ky rezultat ka ardhur pas ekzaminimit me pajisje speciale, përkatësisht me mikroskop dhe pajisja VSC 6000, duke shtuar se ai si ekspert nuk mund të arrij te rezultati duke i parë kartëmonedhat me sy të lirë, por pas ekzaminimit me pajisjet e përmendura më lart, duke i poseduar edhe masat standarde origjinale të kartëmonedhave për krahasim.

Në pyetje nga ATGJ Fatime Dermaku, eksperti F.S. ka thënë se ka raste kur gjatë kontaktit të kartëmonedhave iu dëmtohet hologrami dhe për t'i bërë më të besueshme i vendoset një hologram i imituar – i falsifikuar, e që në këtë rast kemi ardhur në përfundim se hologrami është i falsifikuar, por kohën e falsifikimit të tij nuk mund ta përcaktoj, duke shtuar se nëse mbesin gjurmë gjatë ndërhyrjes në hologram, përgjigje për këtë mund të japin ekspertët e daktiloskopisë dhe se për qytetarët që nuk janë ekspert të kartëmonedhave- dokumenteve nuk është e lehtë të identifikohet me sy të lirë ndërhyrja në kartëmonedha sepse ata janë laik, përkatësisht nuk kanë njohuri. Pastaj, eksperti S. ka thënë se ai mendon se hologrami në kartëmonedhë vendoset me pajisje përkatëse me nxehje dhe presion, e këtë nuk e ka parë në praktikë por mendon se ashtu vendoset, duke theksuar se kanë raste të shpeshta me hologram të dëmtuar, hologram të mbuluar, etj., dhe se kartëmonedhat e falsifikuara qoftë plotësisht apo pjesërisht, ai jep vetëm mendimin, por se a duhet të jenë në qarkullim apo jo, ai nuk vendosë. Po ashtu, eksperti S. ka thënë se ai si ekspert i lëmisë përkatëse në AKF mendon se mund t'i identifikoj me pamje këto kartëmonedha për arsye se i di tiparet e sigurisë, por për qytetarët e rëndomtë është e pamundur sepse nuk kanë njohuri mbi tiparet e sigurisë.

Në pyetje nga ATGJ Ertan Sejfulla, eksperti F.S. është përgjigjur se të gjitha dëmtimet në kartëmonedha ai si ekspert i sheh vetëm me pajisjet e përmendura më lart.

Në pyetje nga mbrojtësja e të akuzuarit V.T., eksperti F.S. ka thënë se falsifikimi i plotë i një dokumenti është imitim i saj dhe asnjëherë nuk është origjinal dhe nuk i posedon tiparet e sigurisë.

Në pyetje nga mbrojtësi i të akuzuarit F.Q., eksperti F.S. është përgjigjur se qëllimi i vendosjes së hologramit të ri bëhet me qëllim të besueshmërisë së kartëmonedhës dhe se të gjitha kartëmonedhat e kanë të njëjtin hologram.

Në pyetje nga mbrojtësi i të akuzuarit D.Sh., av. Gëzim Berisha, eksperti F.S. ka thënë se në AKF nuk përdorin markerët për të vërtetuar nëse paratë janë të falsifikuara apo jo.

Aktgjykimi si më lart është bazuar vetëm në faktet dhe provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç parasheh dispozita e nenit 360 të KPP, e për të cilat do të jepet vlerësimi si në vijim:

Pretendimin e prokurorisë se tani i akuzuari V.T. ka kryer veprën penale Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK, pasi në shtëpinë e tij në shtëpinë e tij në rrugën “.” nr. ... në Prishtinë, policia ka gjetur dhe sekuestruar substanca narkotike prej 3.92 gram e llojit marihuanë, pas këshillimit të mjaftueshëm, pas vlerësimit të të gjitha provave, analizimit dhe vlerësimit të aktakuzës, trupi gjykues ka ardhur në përfundimin se për të akuzuarin V.T. për pikën I të aktakuzës nuk përmbushen elementet e veprës penale Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK, pasi që me asnjë provë nuk është provuar se i njëjti ka shitur apo shpërndarë substanca narkotike dhe gjetja e këtyre substancave të ai nuk e provon kryerjen e veprës penale si me lart, por në veprimet e tij manifestohen plotësisht elementet e veprës penale posedimi i paautorizuar narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK, e këtë e ka pranuar edhe vet i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor, prandaj mbi këtë bazë, trupi gjykues ka bërë ri kualifikimin e veprës penale nga Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267, par. 1 të KPRK në veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK.

Nga Raporti i Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër reference AKF/2023-1829/23-1693, i datës 18.07.2023, lidhur me ekzaminimin e substancës narkotike, ka rezultuar se substanca e ekzaminuar e gjetur te i akuzuari V.T. përbën peshën prej 3.92 gram të llojit marihuanë, e me këtë është vërtetuar se tani i akuzuari T. ka poseduar substancën narkotike të paraqitur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Andaj, pranimi i fajësisë nga i akuzuari T. u mbështet edhe mbi bazën e këtij raporti dhe gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale posedimi i paautorizuar narkotikeve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK, të përshkruar si në dispozitivin e I të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtorë të akuzuarin, për këtë vepër penale, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Nga Raporti i Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr. referencës AKF/2023-1828/23-1692, i datës 23.06.2023 lidhur me ekzaminimin e parave, ka rezultuar se paratë e sekuestruara te të akuzuarit janë pjesërisht të falsifikuara;

Nga vërtetimet mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me nr. të rastit R-2023-XI-DKKO-HTN-NJHMH-3 i datës 22.05.2023 dhe vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nr. rastit 2023-Ke-147 i datës 30.05.2023, është vërtetuar se te tani të akuzuarit janë sekuestruar sendet e paraqitura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi;

Raporti i këqyrjes se vendit të ngjarjes i datës 22.05.2023 nga Njësia e Forenzikës; Lista e dëshmive nga Njësia e Forenzikës e datës 22.05.2023; Foto albumi nga Njësia e Forenzikës i datës 22.05.2023; dhe Procesverbali mbi kontrollin i datës 30.05.2023, nga të cilat nuk vërtetohet se të akuzuarit si më lart kanë pasur njohuri se paratë e vëna në qarkullim nga ata kanë qenë pjesërisht të falsifikuara.

Nga dëshmia e ekspertit të AKF F.S., është vërtetuar se kartëmonedhat e ekzaminuara kanë rezultuar të jenë falsifikim i pjesshëm, përkatësisht të njëjtat kanë pasur ndërhyje apo ndërrim në hologram, i cili është tipar i sigurisë përkatësisht kanë vendosur hologramin e falsifikuar, e i cili vendoset pas prodhimit të letrës, përkatësisht vendoset dhe zhvendoset, e kjo mund të bëhet lehtë sepse ai është një shirit holografik dhe vendoset pas prodhimit të letrës së kartëmonedhës, ndërsa kartëmonedhat e ekzaminuara kanë qenë në gjendje të rregullt, teknika e printimit është sipas standardit, numrin serik është me shtypje të lartë ashtu siç duhet të jetë, kurse reaksioni i ngjyrës nën rrezet UV është i dëmtuar për shkak të kontaktit dhe se pas ekzaminimeve të kryera, ai ka konstatuar se ndërhyje ka vetëm te hologrami, e deri te ky rezultat ka ardhur pas ekzaminimit me pajisje speciale, përkatësisht me mikroskop dhe pajisja VSC 6000. Po ashtu, nga eksperti S. është vërtetuar se kartëmonedhave iu është vendosur një hologram i imituar – i falsifikuar, por se kohën e falsifikimit të tij nuk mund ta përcaktoj dhe se për qytetarët që nuk janë ekspert të kartëmonedhave- dokumenteve nuk është e lehtë të identifikohet me sy të lirë ndërhyrja në kartëmonedha sepse ata janë laik, përkatësisht nuk kanë njohuri dhe se hologrami në kartëmonedhë vendoset me pajisje përkatëse me nxehje dhe presion, e këtë nuk e ka parë në praktikë por mendon se ashtu vendoset, duke theksuar se kanë raste të shpeshta me hologram të dëmtuar, hologram të mbuluar, etj., dhe se kartëmonedhat e falsifikuara qoftë plotësisht apo pjesërisht, ai mund t'i identifikoj me pamje për arsye se i di tiparet e sigurisë, por për qytetarët e rëndomtë është e pamundur sepse nuk kanë njohuri mbi tiparet e sigurisë.

Bazuar në thëniet e ekspertit si më lart dhe në mungesë të dëshmimeve dhe provave relevante, trupi gjykues ka vendosur që të akuzuarit V.T., F.Q. e D.Sh., t'i liroj nga akuza për veprën penale të falsifikimit të parasë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që prokuroria nuk ka arritur të bind gjykatën se të akuzuarit si më lart e kanë ditur se paratë, përkatësisht 94 kartëmonedha nga 50 euro, gjithsej 4700 (katër mijë e shtatëqind) euro janë të falsifikuara, duke pasur parasysh se prokuroria vetëm ka shprehur mendimin e saj pa e përshkruar në aktakuzë dhe pa e mbështetur në ndonjë provë të rëndësishme dhe të besueshme se të akuzuarit e kanë ditur se kartëmonedhat si më lart kanë qenë të falsifikuara pjesërisht, përkatësisht e kanë hologramin të falsifikuar.

Prokuroria në përshkrimin e saj në aktakuzë, pretendon se të tre të akuzuarit, duke e ditur se paraja është e falsifikuar e kanë vënë në qarkullim, e kanë transportuar, pranuar, poseduar ose e kanë përdorur me qëllim që ta vënë në qarkullim si të vërtetë, pa përmendur ndonjë rrethanë apo fakt se të akuzuarit si më lart kanë njohuri, përvojë dhe mjete të posaçme për vendosjen e hologramit në kartëmonedha dhe pa e arsyetuar se përse është bërë ky falsifikim – vendosje e hologramit të imituar në kartëmonedha të cilat sipas AKF janë pjesërisht të falsifikuara.

Në këtë rast bazuar në nenin 3 par. 2 të KPP, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose zbatimin e dispozitave të ligjit penal, janë interpretuar në favor të akuzuarve dhe të drejtave të tyre (In dubio pro reo), sipas këtij kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 363 par. 3 të KPRK, gjykata ka marrë aktgjykim lirues për të akuzuarit, sepse nuk është provuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale si në pikën si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, përkatësisht elementi bazë për inkriminim në këtë veprë penale është dijenia se paraja është e falsifikuar, element ky që as me prova të drejtpërdrejta e as të tërthorta nuk është vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit **sa i përket të akuzuarit V.T.**, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që, ndaj të akuzuarit, gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësues siç janë: pranimin e fajësisë nga i akuzuari për të dy veprat penale për të cilat është shpallur fajtorë; intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht në rastin konkret nuk kemi palë të dëmtuar,

pesha e narkotikut të sekuestruar te i akuzuari është e vogël, përkatësisht 3.92 gram e llojit marihuanë dhe si armë është sekuestruar një karikator me gjashtëmbëdhjetë fishekë të kalibrit 9x19 mm; sipas të dhënave të gjykatës, i akuzuari V.T. nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë deri me datë 5 korrik 2024, **ndërsa gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese.**

Andaj, gjykata të akuzuarit **V.T.** i shqiptoi dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimet e shqiptuara, i përgjigjen shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale për të cilat është shpallur fajtor, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar atij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Po ashtu, duke u bazuar në dispozitat e neneve 71 dhe 72, par. 1, nënpar. 1.4 të KPRK, gjykata ka zbutur dënimin ndaj të akuzuarve si më lart, duke pasur për bazë rrethanat e paraqitura në arsyetimin e këtij aktgjykimi dhe se edhe me dënimin më të butë do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 38 të KPRK.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një vepër penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Për mundësinë e pagesës së dënimeve me gjobë me këste, është vendosur konform dispozitës së nenit 43, par. 2 të KPRK.

Për llogaritjen e masës së paraburgimit në dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit V.T., është vendosur konform dispozitës së nenit 79, par. 1 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 452, par. 1 të KPP, ndërsa vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të neneve: 3; 6 dhe 39, par. 3.2 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi që të akuzuarve t’iu konfiskohen sendet e përdorura për kryerjen e veprës penale, u mor në bazë të neneve 366, par. 3 dhe 269 par. 3 të KPRK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve nenit 269 par. 2 e 3 dhe 366, par. 1 e 3 të KPRK, si dhe neneve 363 e 364 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë **08.07.2024.**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.314/2023, datë **14.06.2024.**

Numri i lëndës: 2023:116813
Datë: 08.07.2024
Numri i dokumentit: 05907859

Bashkëpunëtoreshë profesionale,
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjykues,
Naser Foniqi

UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar **brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh**, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.